

VENDIM
Nr. 183, datë 13.7.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E “BURSËS SHQIPTARE TË ENERGISË ELEKTRIKE – ALPEX” SHA NË VEPRIMTARINË E OPERIMIT TË TREGUT TË ENERGISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “P”, nenit 5, pika 1, germa “P”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.7.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike me nr. 1118/5 prot., datë 13.7.2022, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e ‘Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX’ sh.a. në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 966 prot., datë 27.6.2022, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike.

- “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a. është krijuar bazuar në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM-së) nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”; VKM-së nr. 609, datë 11.9.2019, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së pjesëmarrësve në kapitalin e operatorit të tregut”. Kjo shoqëri do të operojë në tregun shqiptar të energjisë elektrike dhe ka hapur degën e saj edhe në Kosovë, sipas VKM-së nr. 1, datë 27.1.2021, “Për miratimin e hapjes së Degës së Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike në Kosovë”.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik dhe administrativ; dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim – neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”;
- dokumentacioni juridik dhe administrativ – neni 9, pika 2, gjerat “a”, “c” dhe “e”;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3, gjerat “b”, “c” dhe “d”;
- dokumentacioni tekniko-ekonomik për veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike – neni 9, pika 4.9, gjerat “a”, “b”, “d”, “f” dhe “g”.

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar ose të plotësuar pjesërisht, si vijon:

Dokumentacioni juridik dhe administrativ

Neni 9, pika 2:

- gjerat “a”/“b” – shoqëria duhet të sqarojë mungesën e aktit të themelimit;
- gjerat “d” – duhet të depozitohen në ERE vërtetimet e prokurorisë dhe të gjykatës për shoqërinë.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal

Neni 9, pika 3:

- germa “a” – shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin e shlyerjes së tatimeve.

4.9 Dokumentacioni tekniko-ekonomik për licencimin e veprimtarisë së Operimit të Tregut të energjisë elektrike

- germa “c” – në rast licencimi, shoqëria duhet të përcjellë në ERE informacion shtesë periodik mbi implementimin e këtij harduerit dhe softuerit/platformave, siç parashikohet në kontratën përkatëse, për të kryer të gjitha operacionet e bursës.

- germa “e” – në lidhje me dëshminë, që vërteton mundësinë për të zhvilluar të gjitha procedurat operacionale, kontraktuale ose marrëdhëniet e aksesit, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE mekanizmat e saj për mbikëqyrjen e tregut, procedurat dhe kontrollet për mbrojtjen e informacionit konfidencial.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a. në aktivitetin e operimit të tregut të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti